



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 604, datë 17.10.2018

P Ë R

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "D", të titulluar "Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatat ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", shtohet kompania e renditur në shkronjën "b", të listës bashkëlidhur këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

DITMIR BUSHATI

**AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-SË
("LISTA E OKB-së")

**D. LISTA E KOMPANIVE QË I TAKOJNË OSE BASHKËPUNOJNË
ME ORGANIZATAT ISIL (Da'esh) dhe AL-QAIDA**

b) Lista e shtuar në "Listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë
me organizatat ISIL (da'esh) dhe Al-Qaida

1. Jama'a Nusrat ul-Islam ëa al Muslimin (JNIM)

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personat dhe kompanitë, emrat e të cilëve janë
radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të
Pastrimit të Parave.

NR.PROT. 4775/1
DATË 18.10. 2018

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E
JASHTME
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
SHISH
BANKËS SË SHQIPËRISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

